



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 17.06.2021

Nr: 96

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 55, PARAQITUR  
NË KQZ NË DATËN 15.06.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 17.06.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvin LAKO	-	Relator
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilijan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë (PBPPSH);

**OBJEKT:** Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 55, datë 15.06.2021 të subjektit ankues PBPPSH me objekt: “Mosmarrje e vendimit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i pavlefshmërisë së votimeve të zgjedhjeve të datës 25 prill 2021 për Kuvendin e Shqipërisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sepse nuk u zbatua neni 24 i Kodit Zgjedhor, sepse nuk u mor vendim për votimin jashtë shtetit”.

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130, dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e palëve në seancë,



## VËREN:

1. Subjekti ankues Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë, ka depozituar pranë KQZ-së kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 55 regj., datë 15.06.2021. Në mbledhjen e datës 17.06.2021, ora 14:00, pas relatimit të z. Elvin Lako dhe diskutimit të subjektit ankues, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 55 nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor.
2. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve vëren se objekti i kësaj kërkesë nuk përfshihet në sferën e kompetencave të tij.

Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008 ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar, rendit në mënyrë shteruese kompetencat e këtij Komisioni. Bazuar në pikën 1 të nenit 21 të Kodit Zgjedhor, *KAS-i ushtron këto kompetenca:*

- a) vendos për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve në një ose më shumë qendra votimi, në një ose më shumë zona zgjedhore apo në të gjithë vendin, si dhe për përsëritjen e pjeshme ose të plotë të zgjedhjeve;*
- b) shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat ndaj akteve të Komisionerit;*
- c) shqyrton dhe zgjidh në rrugë administrative ankesat e subjekteve zgjedhore ndaj vendimeve të KZAZ-ëve;*
- ç) vlerëson performancën e komisionerëve dhe numëruesve për çështjet që shqyrton;*
- d) me kërkesë të Komisionerit vendos masat disiplinore ndaj zyrtarëve zgjedhorë në rastet kur pas kontrollit a posteriori të materialit zgjedhor janë konstatuar shkelje ose parregullsi në administrim;*
- dh) me kërkesë të Komisionerit vendos sanksione administrative kundër personave apo subjekteve zgjedhore dhe/ose kandidatëve të tyre, që kryejnë kundërvajtje administrative në lidhje me zgjedhjet.*

Subjekti ankues nuk referon në kërkesën e tij ankimore asnjë vendim të cilin kundërshton në KAS. Mbështetur në dispozitën ligjore të mësipërme, rezulton se objekti i kërkesës ankimore nr. 55 nuk përfshihet në asnjë nga shkronjat e pikës 1 të nenit 21 të Kodit Zgjedhor, dhe për pasojë nuk mund të merret në shqyrtim nga KAS.



3. Për sa i përket votimit nga jashtë vendit, KAS konstaton se kompetenca për të marrë vendim lidhur me rregullat dhe procedurat përkatëse, i takon Komisionit Rregullator, bazuar në nenin 20, pika 1, shkronja “dh” të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet se: *“Rregullatori shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për (...) rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, për procedurat e tyre të votimit, për administrimin dhe numërimin e votave nga jashtë vendit dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvendin”*.

Duke qenë se subjekti ankues pretendon se nuk është marrë vendimi sipas nenit 24/1 të Kodit Zgjedhor; në këtë rast, referuar nenit 145, pika 2 të Kodit, *subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor për mosmarrje të vendimit brenda afatit ligjor nga KQZ-ja*.

Pra, KAS nuk është organi kompetent për të shqyrtuar kërkesën për mosmarrjen e këtij vendimi.

4. Më tej, nëse subjekti ankues kërkon pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre sipas neneve 160, 161 të Kodit Zgjedhor, në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, referuar nenit 124 të Kodit, afati për të kërkuar diçka të tillë është 5 ditë nga shpallja e vendimit për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zonës Zgjedhore. Në kohën që flasim ka kaluar çdo afat ligjor për bërjen e një kërkesë të tillë ankimore pasi Tabelat janë miratuar në datën 04.05.2021. Kërkesa ankimore për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre në disa qarqe të Republikës së Shqipërisë janë depozituar nga disa subjekte zgjedhore brenda afatit të mësipërm dhe janë shqyrtuar nga ky Komision, i cili ka marrë 10 vendime për këto çështje.

## PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenet 21, 126 dhe 130, shkronjat “a” dhe “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenet 17, pika 3, shkronja “b” dhe neni 18, pika 1, shkronjat “a” dhe “c” të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, KAS-i,



## VENDOSI:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 55, datë 15.06.2021 të paraqitur nga Partia Bashkimit Popullor i Pensionistëve Shqiptarë;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 ditëve nga shpallja e tij.

**Elvin LAKO** - **Relator**

**Elvis ÇEFA** - **Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI** - **Anëtar**

**Koli BELE** - **Anëtar**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**

